



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
STRUKTURA E POSAÇME KUNDER KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TE
ORGANIZUAR
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR



RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT

8 maji 2023

Shtator 2023

KUADRI LIGJOR RREGULLATOR

1. LIGJI 95/2016 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR”, I NDRYSHUAR.
2. LIGJI 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”
3. LIGJI NR. 9936, DATË 26.06.2008 “PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR.
4. LIGJI 10296, DATË 08.07.2010 “PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN” (I NDRYSHUAR),
5. LIGJI NR.84/2022 “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”,
6. UDHËZIMI I MINISTRIT TË FINANCAVE DHE EKONOMISË NR.9, DATË 20.03.2018 “PËR PROCEDURAT STANDARTE TË ZBATIMIT TË BUXHETIT”
7. UDHËZIMIT NR. 2, DATË 19.01.2023 “PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023”,
8. UDHËZIMIT NR.14, DATË 30.05.2023 “PËR PROCEDURAT STANDARTE TË MONITORIMIT TË BUXHETIT PËR NJËSITË E QEVERISJES QËNDRORE”

<i>TABELA E PERMBAJTJES</i>

- 1 HYRJE*
- 2 INFORMACIONI BUXHETOR I AGREGUAR*
- 3 PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË
GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI*
- 4 PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT*
 - 4.1.PERFORMANCA FINANCIARE E PROGRAMT BUXHETOR*
 - 4.2.PERFORMANCA JO-FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR*
 - 4.3.VEPRIMET VIJUESE NË NIVELIN E PROGRAMIT BUXHETOR*
- 5 PROJEKTET KAPITALE*
- 6 NDRYSHIMET NË BUXHET*
- 7 PËRFUNDIME*

1 HYRJE

Monitorimi i zbatimit të buxhetit të 8-mujorin e vitit 2023 për Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e SPAK-ut kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar në përputhje me planin strategjik të ecursisë së institucionit dhe të gjitha kërkesave ligjore. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të SPAK-ut në krahasim me planin e miratuar, të detajuar në nivel treguesi performance. Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor i mundëson institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Me qëllim për të kontribuar në proceset bazë të misionit dhe objektivave të institucionit buxheti i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, do të mbështetet plotësisht në udhëzimet standarde të hartimit të buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës, por gjithashtu dhe monitorimin e realizimit buxhetor mbështetur mbi ato tregues të planifikuar gjatë hartimi të programit buxhetor afatmesëm. Ky raport zyrtar do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës SPAK do të synojë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecursisë së institucionit.

2 INFORMACIONI BUXHETOR I AGREGUAR


Buxheti i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2023 është miratuar me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” i ndryshuar, ku në total rezulton të jetë planifikuar një vlerë prej 1,178 milionë lekë. Gjatë 8 mujorit 2023, këto burime financiare SPAK si një institucion kushtetues, i ka përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligj. Fondet buxhetore të miratuara përmes ligjit vjetor të buxhetit, SPAK i ka administruar për financimin e aktiviteteve në një program të përcaktuar me emertimin “Veprimtaria e SPAK”. Raporti përmbledhës i shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

Tabela 1: Raporti përmblledhës i shpenzimeve

(000/lekë)

Programi		Veprimtaria e SPAK					
		Viti paraardhës 2022		Viti Raportues 2023			
		Shpenzime faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2023	Plani vjetor i rishikuar Viti 2023	Ndryshimi i planit vjetor periudha raportuese	Struktura e shpenzimeve në %
1	2	3	4	4	5	6	7
600	Paga	429,825.6	73%	782,509.0	837,509.0	-55,000.0	68%
601	Sigurime Shoqërore	38,006.1	6%	200,374.0	140,374.0	60,000.0	11%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	99,042.2	17%	128,117.0	188,117.0	-60,000.0	15%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,838.9	0%	329.8	329.8		0%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	568,712.8	97%	1,111,329.8	1,166,329.8	-55,000.0	95%
231	Kapitale të Trupëzuara	19,350.4	3%	67,000.0	67,000.0	0.0	5%
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	19,350.4	3%	67,000.0	67,000.0	0.0	5%
Totali		588,063.2	100%	1,178,329.8	1,233,329.8	-55,000.0	100%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2023);



Grafiku 1: Struktura e shpenzimeve për periudhën paraardhëse dhe vitin raportues

1.Në mënyrë tabelare dhe grafikut paraqitet struktura e shpenzimeve për vitin paraardhës dhe periudhën raportuese. Për vitin paraardhës struktura e shpenzimeve paraqitet bazuar në faktin e realizuar, ndërsa për periudhën raportuese paraqitet mbi planin e rishikuar.

2.Për sa i përket rialokimeve të shpenzimeve sqarojmë se:

a)Nga Prokuroria e Posaçme me shkresën Nr. 6160 prot., datë 28.04.2023, miratuar nga MFE me shkresën Nr.8074/1prot., datë 16.05.2023, është kërkuar rishpërndarja e shpenzimeve (nga 601 në 602) në shumën 60 milionë lekë, kërkesë e cila ka qënë bazuar në kërkesat e shtuara të cilat lidhen me shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë si sistemi i bërthamës komanduese ai i ekspertizës dhe i IT, kërkesa të cilat janë referuar dhe në PBA 2023-2025.

b)Me shkresën 8872, datë 21.06.2023 është miratuar riallokimi i fondit 1.24 milionë lekë shpenzime për paga (nga Prokuroria kaluar BKH-së) për të mbuluar efektet nga zbatimi i VKM 325/2023. Gjithashtu gjatë periudhës 8-mujore janë reflektuar ndryshimet në Regjistrin e

parashikimit të procedurave të prokurimit, (njoftuar Degën e Thesarit rast pas rasti) bazuar në fondin limit të rezultuar nga studimi i tregut si dhe shtimi i zërit “Shërbim për rinovimin e licencave për mirëmbajtjen e pajisjeve të Sektorit të Ekspertizës”

3.Për sa i përket numrit të punonjësve me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, për SPAK struktura e miratuar është për 271 persona, nga të cilët 133 persona Prokuroria e Posaçme dhe 138 persona Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH). Efektiv janë 179 persona nga të cilët 106 persona në Prokurorinë e Posaçme dhe 73 persona në BKH. Aktualisht të dy institucionet po vijnë procedurat për plotësimin e strukturave.

3 *PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI* Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk ka parashikuar tregues performance me bazë gjinore në nivel produkti, ngelet një nga prioritetet e SPAK.

4 *PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT*

4.1.*PERFORMANCA FINANCIARE E PROGRAMT BUXHETOR*


Qëndrueshmëria financiare e institucionit dhe ndjekja me rigorozitet e procedurave të menaxhimit financiar publik, kanë udhëhequr veprimtarinë administrative të SPAK. Duke u mbështetur mbi veprimtarinë bazë të instiucionit, shpërndarja e planit të shpenzimeve buxhetore lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punës dhe kërkesat e SPAK, pjesë e të vilës janë Prokuroria e Posaçme dhe BKH. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave për 8-mujorin e vitit 2023, krahasuar me planin e parashikuar për 8- mujorin dhe atë vjetor në programin buxhetor “Veprimtaria e SPAK”, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Raporti i Shpenzimeve të programit

(000/lekë)

Art.	Emertimi	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	Buxheti I planifikuar per 8- mujorin	Fakti I realizuar per 8-mujorin	Diferenca plan/fakt 8 mujor	Perqindja e realizimit Plan/Fakt 8-mujor (%)	Diferenca Plan vjetor/Fakti 8-mujor	Perqindja e realizimit Plan vjetor/Fakt 8 mujor(%)
1	2	3	4	5	6=(4-5)	7=(5/4)	8=(3-5)	9
600	Paga	837,509.0	496,380.3	443,046.1	53,334.2	89%	341,129	53%
601	Sigurime Shoqërore	140,374.0	73,049.4	37,298.1	35,751.3	51%	67,325	27%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	188,117.0	149,858.9	60,805.4	89,053.5	41%	38,258	32%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	329.8	329.8	200.0	129.8	61%	-	61%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	1,166,329.8	719,618.3	541,349.5	178,268.8	75%	446,711.5	46%
231	Kapitale të Trupëzuara	67,000.0	67,000.0	0.0	67,000.0	0%	-	0%
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	67,000.0	67,000.0	0.0	67,000.0	0%	-	0%
Totali (korrente + kapitale)		1,233,329.8	786,618.3	541,349.5	245,268.8	69%	446,711.5	44%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2023);



Grafiku 2: Pesha specifike e realizimit të shpenzimeve sipas zërave buxhetor

1. Duke marrë në analizë peshën specifike të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike mbi totalin e buxhetit të realizuar për 8-mujorin rezultojnë se pjesën më të madhe të planit të shpenzimeve buxhetore e zë llogaria “Paga” në rreth 89%, pas tij llogaria “Sigurime” me rreth 51% si dhe “Mallra dhe shërbime të tjera” në rreth 41%. Duke u mbështetur mbi veprimtarinë bazë të institucionit, kjo peshë specifike lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punës dhe kërkesat e SPAK për të përmbushur detyrimet ligjore. Për sa i përket realizimit faktik për 8-mujorin krahasuar me buxhetin vjetor të miratuar rezultojnë se përqindja e realizimit sipas zërave buxhetorë paraqitet: shpenzime për paga rreth 53%, shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera rreth 32% dhe shpenzime për sigurime rreth 27%.

2. Krahasuar me periudhën e mëparëshme të raportimit (viti 2022 pasqyra 1), shpenzimet buxhetore për paga të realizuara për 8-mujorin janë afërsisht deri në nivelin e shpenzimeve buxhetore të realizuara për vitin 2022 (443.6 milion lekë 8-mujori/429.9 milion lekë viti 2022). Kjo rritje e nivelit të shpenzimeve të realizuara për 8-mujorin është kryesisht rrjedhojë e shtimit të numrit të punonjësve, procedurë e cila vijon deri në plotësimin e plotë të strukturave si dhe efekteve nga zbatimi i akteve ligjore/nënligjore për vitin 2023 lidhur me pagat e magjistratëve dhe jomagjistratëve dhe ato të personelit administrativ. Në zbatim të përcaktimeve ligjore, ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” deri në përfundim të ushtrimit (viti 2023), BKH pritet të jetë në funksion të plotë me personelin e OPGJ dhe atë administrativ, duke ndikuar në këtë mënyrë në rritjen e shpenzimeve gjatë pjesës tjetër të vitit. Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme është në një proces të

vazhdueshëm rekrutimi deri në konsolidimin e strukturave për zbatimin e plotë të kërkesave ligjore të sipërcituara.

3. Shpenzimet e kryera për të cilat janë përdorur fondet e planifikuara i referohen kryesisht shpenzimeve nga realizimi i kontratave 2-vjecare, Marrëveshjet Kuadër nga viti 2022, shpenzime utilitare, shpenzime ekspertiza, shërbime kadastrale, udhëtime-dieta, si dhe mallra e shërbime sipas planifikimit në regjistrin e prokurimeve si dhe nevojave të institucionit. Sa trajtuar dhe më lartë për të përmbushur detyrimet kontraktuale lidhur me kontratat 2- vjecare (shpenzime të mirmbajtjes së sistemeve të bërthamës elektronike dhe IT, shpenzime të shtuara për vitin 2023 krahasuar më vitin 2022 në shumën 35 milionë lekë si dhe realizimin e procedurës së prokurimit “Shërbim për rinovimin e licencave për mirëmbajtjen e pajisjeve të Sektorit të Ekspertizës” në shumën 26 milionë lekë është kërkuar rialokimi i fondeve në total në shumën 60 milion, kërkesë e cila është miratuar nga MFE. Për vitin 2023 shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë parashikohen rreth 76 milionë lekë (30 milionë shpenzime mirëmbajtje bërthama komanduese, 20.1 milionë shpenzime mirëmbajtje sisteme të IT dhe 26 milionë (procedurë në proces) shpenzime rinovim programe të ekspertizës. Gjatë periudhës Janar-Gusht 2023, janë realizuar 12 procedura prokurimi në vlerën 16.7 milione lekë nga të cilat 3 procedura Marrëveshje Kuadër. Bazuar në nevojat e institucionit për kanceleri, karburant, shërbim mirëmbajtje automjete janë lidhur 5 minikontrata nga Marrëveshjet Kuadër të vitit 2022, në vlerën 11.9 milion lekë. Aktualisht janë në proces 4 procedura prokurimi, midis të cilave dhe shërbimi i mirmbajtjes së godinës ku ushtron aktualisht funksionet Struktura e Posaçme.

5. Për sa i përket investimeve me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, janë planifikuar për tu realizuar në formën e investimeve pranë SPAK vlera prej 67,000 milion lekë me qëllim mbulimin e shpenzimeve të nevojshme në formën e investimeve. Gjatë periudhës 8- mujore janë inicuar procedurat e prokurimit për pajisje elektronike, për automjete, për pajisje procedurale/operacionale, për pajisjen “Skaner për dedektimin e automjeteve” procedura të cilat janë në proces. Nuk është inicuar procedura “Blerje mobilje zyre” procedurë e cila lidhet me mobilimin e ambjentit të ri ku do akomodohet një pjesë e personelit të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Duke qënë ndërtimi i godinës së re i është përshtatur kërkesave të Institucionit që e ka patur në pronësi Ish ujsjellës Kanalizime, për të qënë funksionale për personelin e Strukturës së Posaçme, fillimisht duhet të merrën masa për


përshtatjen si të ambjenteve të brendshme dhe të pjesës së jashtme të godinës pasi si objekt i rëndësishë së veçantë do të kalojë në ruajtje nga Garda e Republikës.

6. Për vitin buxhetor 2023, për Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është planifikuar si Fond i Veçantë (Llogaria 606) për mbulimin e rasteve të fatkeqësive në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave vlera prej 329 mijë lekë. Ky fond gjatë 8 muhorit të vitit 2023 është përdorur në vlerën e 200 mijë lekë, duke mbuluar plotësisht rastet e sëmundjeve të rënda të punonjësve. Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, gjatë 8- muhorit të parë të vitit buxhetor 2023 nuk ka krijuar të ardhura jashtë limiti dhe si rrjedhim të gjitha efektet financiare janë mbuluar brenda buxhetit vjetor të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit. Gjatë 8 muhorit të parë të vitit 2023, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka likuiduar me korrektesë të gjitha detyrimet të krijuara nga aktiviteti ndaj palëve të treta.

4.2. PERFORMANCA JO-FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR

Realizimi i produkteve buxhetore në nivel performance për Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për 8- muhordin e parë të vitit 2023 paraqiten si më poshtë:

Emertimi i Treguesit të Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit 2022	Niveli i planifikuar në vitin 2023	Niveli i rishikuar në vitin 2023	Niveli faktik në 8 muhordin e parë të vitit 2023	% e Realizimit të Treguesit të Performances/Produktit	Sqarime
Raporti midis numrit të çështjeve të përfunduara (hetuara) kundrejt atyre të regjistruara (nën hetim).	30%	80%	50%	31%	62%	Për 8-muhorin 2023 janë regjistruar 209 procedime penale +460 të mbartura, në total procedime në hetim janë 669 nga të cilat kanë përfunduar 111 (29 për gjykim +17 pushim +53 transferuar për kompetencë +12 pezullime)
Raporti midis numrit të çështjeve të dërguara për gjykim kundrejt atyre të përfunduara (hetuara).	29%	70%	35%	26%	75%	Për vitin 8- muhordin 2023 janë dërguar në gjykatë me Kërkesë për Gjykim 29 procedime penale nga 111 të zgjidhura
Raporti midis numrit të personave të gjykuar (hetuar) kundrejt atyre të regjistruar (nën hetim).	57%	65%	60%	37%	61%	Për 8- muhordin 2023 ka përfunduar hetimi për 165 persona nga 449 persona nën hetim



Grafiku 3: Realizimi i treguesëve për periudhën paraardhëse dhe atë raportuese

Për sa konstatohet më lart në tabelën e paraqitur produktet buxhetore të planifikuara në programin “Veprimtaria e SPAK” kanë një nivel realizimi të kënaqshëm, në kushtet e argumenteve si më poshtë vijon:

1.Lidhur me produktin 94101AB, është dhënë informacioni mbi mënyrën e llogaritjes për cdo tregues të performancës.SPAK është një institucion i krijuar në vitin 2020 dhe ka shumë çështje të mbartura, aktualisht nën hetim janë 460 çështje. Nëse i referohemi çështjeve të zgjidhura për 8-mujorin e parë të vitit 2023, 111 çështje, me ato të regjistruara për 8-mujorin e parë 2023, regjistruar 209 çështje ky raport paraqitet rreth 53% ($111/209 \cdot 100$). Sa trajtuar dhe në raportimin e periudhës 4- mujore, rishikimi i treguesve është bërë bazuar në faktin e treguesve të realizuar për vitin 2022 si dhe numrin e lartë të dosjeve të mbartura në Prokurorinë e Posaçme, krahasuar me numrin e dosjeve parashikuar për të përfunduar për vitin 2023. Për vitin 2023 janë parashikuar për të përfunduar 190 dosje të cilat krahasuar vetëm me numrin e dosjeve të mbartura 460 dosje, pa marrë parasysh ato që regjistrohen në vitin 2023, është rreth 41% e totalit të dosjeve nën hetim ($190/460 \cdot 100$). Struktura e Plosaçme është në proces vlerësimi lidhur me rishikimin të treguesve të preformancës në nivel Qellimi dhe Objektivi.

2.Lidhur me produktin 19AA604 Blerje autovetura bazuar në fondin limit të përlllogaritur nga studimi i tregut rreth 8 milionë lekë është parashikuar realizimit në sasi sipas parashikimeve.

3.Lidhur me produktet:19AA605 blerje pajisje elektronike në shumën 5 milionë lekë, 19AA606 blerje pajisje procedurale/operacionale për strukturat e BKH-se në shumën 6 milionë lekë dhe 19AA607 blerje skaner për dedektimin e automjeteve në shumën 11 milionë lekë aktualisht

procedurat janë në proces. Me përfundimin e procedurave do të vijojë analiza, në sasi dhe në vlerë, e produkteve të realizuara krahasuar me ato të planifikuara në sasi dhe në vlerë.

4.Lidhur me produktin 19AA603 blerje pajisje zyre në shumën 35milionë lekë për arsyet e trajtuara më lartë(realizimi i të cilit lidhet me përshtatjen fillimisht të ambjenteve të Godinës së re në funksion të nevojave të institucionit) nuk është inicuar procedura e prokurimit.

4.3.VEPRIMET VIJUESE NË NIVELIN E PROGRAMIT BUXHETOR

Në pjesën e mbetur të vitit pritet realizimi i fondeve të parashikuara brenda buxhetit të vitit 2023 duke synuar përdorimin me eficiencë dhe efektivitet maksimal të burimeve financiare në raport me rritjen e nivelit të performancës së treguesve të zbatimit të ligjit të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

5.PROJEKTET KAPITALE

1.Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar sipas programit buxhetor të miratuar ka parashikuar projekte për investime në vlerën 67 milionë lekë sipas produkteve të trajtuara dhe më lartë.

2.Midis Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), është lidhur kontrata për projektin me objekt: “Blerje të pajisjeve dhe sistemeve elektronike për rritjen e sigurisë kibernetike dhe sistemit teknologjik për suportin e hetuesve në terren” në vlerën 169,208,320 lekë. Aktualisht Prokuroria e Posaçme ka inicuar procedurat e prokurimit për realizimin e projektit me objektin e sipërcituar.

6.NDRYSHIMET NË BUXHET

Rrjedhojë ndryshimeve ligjore në vitin 2023, me VKM Nr. 437 prot., datë 19.07.2023 “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023” është miratuar akordimi i fondit shtesë në shumën 55 milionë lekë. Gjithashtu, për godinën e re Prokuroria e Posaçme është anagazhuar për marrjen e masave për ndryshimet në infrastrukturë dhe teknologji me qëllim përshtatjen e Godinës së re në funksion të Institucionit dhe me pasjen e një preventivi të plotë lidhur me kërkesat buxhetore do të iniciojmë kërkesën drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

7.PËRFUNDIME

Menaxhimi Financiar i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është fokusuar në financimin e shpenzimeve për përmbushjen e objektivave prioritare strategjike të institucionit të cilat konsistojnë kryesisht në:

- *Përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve të institucionit, duke rritur numrin e çështjeve hetimore në proporcion me problematikat e shkeljes së ligjit për rastet e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe paraqitjen e një produkti hetimor cilësor, që përkthehet në raste të suksesshme të përfunduara dhe të dërguara për gjykim pranë GJKOK.*
- *Krijimi i të gjitha kapaciteteve të nevojshme për Prokurorët, Hetuesit e Prokurorisë së Posaçme dhe të BKH-së si dhe personelin administrativ, në funksion të arritjes së rezultateve pozitive në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.*
- *Ofrimi i sigurisë maksimale fizike dhe financiare për personelin hetimor dhe administrativ të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si një garanci afatgjatë e integritetit Kushtetues të Institucionit.*
- *Përdorimin e teknologjisë më të avancuar në funksion të ekspertizës dhe hetimeve proaktive sipas kompetencës ligjore të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.*